

Në bazë të nenit 46 të ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe nenit 18, 19 të Statutit të përkohëshëm të Odës së Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës, Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë pas konsultimit me këshillin për përgaditjen dhe konstituimin e Odës së Profesionistëve Shëndetësorë miraton këtë:

RREGULLORE

PËR PROCEDUREN E KANDIDIMIT, MËNYRËN E ZGJEDHJES DHE REVOKIMIN E ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS SË INFIERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e kandidimit, e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor të Kosovës: Kuvendit, Kryetarit të Odës, Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës për buxhet dhe financa, Këshillit Etikë, Gjyqi i Nderit, Prokurorit të Odës, dhe Komisioneve të tjera të përhershme.

II. ORGANET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Neni 2

Organet për zbatimin e zgjedhjeve për organet e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor të Kosovës janë:

Komisioni Qendror Zgjedhorë, Komisioni Profesional Zgjedhore dhe Komisionet e njësjive zgjedhore.

Komisioni Qendror Zgjedhorë ka 5 anëtarë dhe 5 zv.anëtarë të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë.

Komisionin Profesional Zgjedhor me propozim të Këshillit përkatës për përgatitjen e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor të Kosovës e emëron Ministri i Shëndetësisë.

Anëtarët e Komisionit të njësisë zgjedhore i emëron Komisioni Qendrorë Zgjedhorë në bazë të propozimit të njësisë zgjedhore.

Anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhorë dhe Komisioneve të njësisë zgjedhore emërohen më së voni 30 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Odës.

Neni 3

Ministria e Shëndetësisë siguron mjetet e nevojshme për zbatimin e zgjedhjeve të destinuara për :

- Kompensim të anëtarëve të komisioneve zgjedhore
- Shpenzimet e informimit publikë
- Angazhim të personave tjerë për nevojat e procesit zgjedhorë
- Shtypjen e materialit zgjedhorë
- Sigurimin e materialit zgjedhorë dhe materialeve tjera shpenzuese
- Paisjet dhe mjetet e nevojshme teknike për zbatimin e zgjedhjeve
- Shpenzimet e rrugës, post-telekumunikacionit, etj.

III. PROCEDURA E KANDIDIMIT DHE ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR

1. ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR

Neni 4

Këshilli për përgatitjen dhe konstituimin e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë do të marrin vendim për shpalljen e